

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: " Infra - Plus " SH.P.K., Rr. Luan Haradinaj Sol. 1 H.1 - 10000, Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	25.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **24.07.2023**, të parashtruar nga **Operatori Ekonomik: "Infra - Plus" SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga **Operatori Ekonomik: "Infra - Plus" SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **20.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-it PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: "Infra - Plus" SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I TË DHËNAVE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE NDËRTIMI I WEBGIS-IT PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-23-5382-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-040-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **20.07.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **24.07.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Pretendimi 1

Ju si Autoriteti Kontraktues keni vendosur që të na eliminoni dhe keni marrë për bazë kërkesën teknike dhe profesionale

1.1. Menaxheri i Projektit – Bachelor i Diplomuar në Shkenca Komputerike, me përvojë pune min. 7 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në fushën e IT, GIS apo të ngjashme);

• Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1.1

Ne konsiderojmë se AK-ja ka bërë shkelje të LPP-se kur na ka eliminuar sepse kërkesën që ju pretendoni se nuk e kemi përmbushur nuk është e vërtetë sepse në kontratën e punës të bashkangjitur me ofertën tone neni 2 i kontratës e qartëson pozitën e stafit të bashkangjitur

NENI 2

I punësuar do t'i kryej këto detyra të punës: **Menaxher i Projektit**
(emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave)

Poashtu në emërtimin e personelit në oferte mund ta shihni se i njëjti është kontraktuar si menaxher i projektit dhe deklarimi se nuk mund të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilëve është e fiksuar është e pasakte sepse në marrëveshjen në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit e kemi definuar këtë çështje në përputhje me LPP-ne.

Për me tepër ju si AK është dashur në bazë të nenit 72 të LPP-se të kërkojë sqarime e pastaj të vendos a plotësohet kriteri që ju i referoheni.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik. Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit.

Në Njoftimi për Kontrate/Dosjes se tenderit, tek

Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar:

1.1. Menaxheri i Projektit – Bachelor i Diplomuar në Shkenca Komputerike, me përvojë pune min. 7 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në fushën e IT, GIS apo të ngjashme);

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1

- Diplomati përkatës – Kopje të noterizuar;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;
- Certifikata përkatëse – Kopje;
- Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 1.1

Por duke u thirrur në nenin 10 të Udhëzuesit, nuk kemi mundur të kërkojmë sqarime shtesë për Dorëzimin e Deklaratës për caktimin e Menaxherit të Projektit, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, **Ku dokumentet në fjale nuk mund të kërkohej në bazë të Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive; Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.**

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pretendimi 2:

Pretendimi jone i dytë është se AK ka bërë shkelje kur na ka eliminuar sepse ne jemi të përgjegjshëm dhe kemi çmimin me të lirë në bazë të poentimit. OE i rekomanduar për kontratë ka çmim me të lartë ndërsa AK-ja e ka arsyetuar me çmim të përgjegjshëm me të lirë.

AK ka bërë shkelje ligjore dhe i ka vënë në lajthitje OE në këtë aktivitet të tenderimit për shkakun se sipas paramasës dhe parallogaritës ky tender nuk është dashur të tenderohet si çmim i poentuar sepse sipas sqarimeve të AK-se vet AK ka qene ne dijeni për saktë e saktë për këtë aktivitet.

Sipas AK-se pozicioni nën 1 dhe nën 2 i paramasës ka qene 562 km dhe 30000 m' dhe në bazë të këtyre dy pozicioneve i ka vlerësuar OE tjerë që kanë qene pjesë e procedurës.

Nëse e analizojmë paramasën shpërfaqet lajthitja që AK-ja ka vënë OE tjerë përveç OE të rekomanduar për kontratë.

Pozicioni nr. 3 është pozicion që realizohet vetëm një herë.

Pozicioni nr. 4 është pozicion që realizohet vetëm 3 ditë sipas përshkrimit

Pozicioni nr. 5 është pozicione që realizohet për 10 ditë sipas përshkrimit

Te gjitha pozicionet tjera janë pozicione që ipet një çmim për komplet shërbimin

Sipas paramasës vetëm dy pozicionet që AK-ja edhe pse i ka ditë nuk i ka vendos qene vendimtare për shpërbim të kontratës e këto dy

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Në bazë të Dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit: Komuna e Rahovecit ka parashikuar shumën prej: **124,000.00 €**. Në bazë të kalkulimeve vërehet se oferta e dhënë nga kompania juaj e tejkalon shumën e paraparë për këtë projekt (afërsisht: **1,557,600.00 €**), sipas PZHK-së Komuna e Rahovecit ka gjithsej rrugë **562 km**.

[https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-](https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2018/10/00_PZHK_Rahovec_DRAFT_d.pdf)

[content/uploads/sites/23/2018/10/00_PZHK_Rahovec_DRAFT_d.pdf](https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2018/10/00_PZHK_Rahovec_DRAFT_d.pdf)

Oferta juaj për pikën 1 të Përshkrimit të Çmimeve (**Digjitalizimi i rrugëve për tërë territorin e komunës Rahovecit dhe kategorizimi i tyre sipas gjendjes (Rrugët fushore dhe gjendja e tyre fizike, rrugët publike me kubëzim, asfaltim dhe elemente betoni**), Njësia matëse: Km, Çmimi për njësi i ofruar nga ana juaj është: 750.00 €, që do të thotë vetëm pika 1 do ti kushtoj Komunës së Rahovecit: **421,500.00 €**;

Njëjtë është edhe për pikën 2 (**Digjitalizim i trotuareve dhe kategorizimi i tyre sipas gjendjes, klasifikimi i ndërtimit – kubëzim, asfaltim dhe elementet e tjera**), Njësia matëse: m', Çmimi për njësi i ofruar nga ana juaj është: 35.00 €, që do të thotë vetëm pika 2 do ti kushtoj Komunës së Rahovecit: **1,050,000.00 €**;

Sipas të dhënave të afërta në Komunën e Rahovecit janë së paku: **30,000.00 Metra gjatësi me trotuare**.

Duke mbledhur shumën e totalit për pikat e lartë përmendura por edhe për pikat e tjera të ofruara nga Kompania juaj, në fund del shuma totale: 1,557,600.00 €, që është jashtë shumës së paraparë nga Komuna e Rahovecit

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit